UNIVERSITETI I PRISHTINËS

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I MJEKËSISË
PRISHTINË
Pranuar me dt. 29/06/2026

| Njësia org. | Numër | Nr.skzompi | Vlera |
|---|---|---|---|
| | 12148 | | |

Nr. Prot:____________________
Datë: ______/______/______

# RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (*ad junct*)

| | |
|---|---|
| Fakulteti: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Pozita e shpallur në thirrje: | Pozita 10 |
| Lëndët: | Mjekesi interne (Hematologji) ☒ |
| Kandidatët e paraqitur: | Hajdin Çitaku<br>Liridona Gashi<br>Doygu Kaçka<br>Ermira Bajrami<br>Erblin Beqiraj<br>Shpat Rrusta<br>Vlora Bujupaj |
| Thirrja për angazhim: | Nr. prot. ---1/746-----------, Dt. -------29/5/2026------ |



Scanned with CamScanner

Per angazhim te profesorave dhe asistenteve per ligjerata, respektivisht ushtrime ne baze te nevojave te njesive akademike te Universitetit te Prishtines per vitin akademik 2026/2027

Komisioni vlerësues:

| | | |
|---|---|---|
| 1. | **Kryetar** | Prof. asoc. Dr. Venera Berisha-Muharremi |
| 2. | **Anëtar** | Prof. asoc. Dr. Argjira Juniku-Shkololli |
| 3. | **Anëtar** | Prof. asst. Dr. Ibadete Bytyçi |



Scanned with CamScanner

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Grada shkencore | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata | | | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime | | | Mosha (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Thirrja akademike | Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP | Përvoja e punës | Nota Ba. | Nota Ma. | Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë/ përkatësisht certifikata profesionale për kontabilitet dhe auditim | | | | |
| 1. | Hajdin Çitaku | Dr.sci. | | | | 8.57 | | Specialist i Mjekesise Interne dhe Kardiolog | 55 | Bashkepun-etor i jashtem per ushtrime: UP, FM, Lenda: Mjekesia Interne 2022/2023 2023/2024 | Bie ndesh me Nenin 7, pika 3.4. | JO |
| 2. | Liridona Gashi | MD | | | | 9.02 | | Nuk ka | 27 | / | Bie ndesh me Nenin 7, pika 3.4. | JO |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | Doygu Kaçka | MD<br>PhD kand-idat | | | | 9.44 | | Specialist i Hematologjise | 26 | Bashkepun-etor i jashtem per ushtrime: UP, FM, Lenda: Fiziologjia patologjike 2023/2024 2025/2026 | Nuk bie ndesh | PO |
| 4. | Ermira Bajrami | MD<br>PhD kand-idat | | | | 9.05 | | Specializante e Mjekesise Interne ( viti 3) | 27 | / | Bie ndesh me Nenin 7, pika 3.4. | JO |
| 5. | Erblin Beqiraj | MD | | | | 8.47 | | Specialist i Kardiokirurgjisë | 31 | / | Bie ndesh me Nenin 7, pika 3.4. | JO |
| 6. | Shpat Rrusta | | | | | 8.52 | | Specialist i Hematologjise | 38 | Bashkepun-etor i jashtem per ushtrime: UP, FM, Lenda: Mjekesia Interne-HEMATOLOGJI 2023/2024<br>Asistent i rregullt ne Kolegjin Rezonanca 2021-aktualisht | Nuk bie ndesh | PO |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7. | Vlora Bujupaj | Teknik i anesteziologjise | | | | 8.89 | | Nuk ka | 24 | / | Bie ndesh me Nenin 7, pika 3.1. dhe 3.4. (Edhe Diplomen ne Bachelor nuk e ka ne MP, por ne drejtimin „Teknik i Anesteziologjise" – Kolegji UBT) | JO |

Scanned with CamScanner

## RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

*Ky raport duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohet/n për angazhim si bashkëpunëtor/ë i/të jashtëm).*

Në procedurën e vlerësimit të aplikacioneve për pozitën VII, nënpika 10 – Mjekësi Interne (Hematologji), të THIRRJES PUBLIKE për angazhim të asistentëve për ushtrme në bazë të nevojave ta njësive akademike të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2026/27, Komisioni recensues ka vepruar në përputhje me kushtet e përcaktuara në Thirrjen Publike dhe me parimin e përputhshmërisë së kualifikimit profesional me fushën për të cilën është shpallur pozita.

Duke respektuar kushtet e Konkursit nr. 1/746, dt. 29.05.2026 dhe specifikisht Nenin 7 – pika 3 të Rregullores nr. 2/254, dt. 17/7/24, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP, kandidatët **Doygu Kaçka** (nr. rendor **3**. në Tabelë) dhe **Shpat Rrusta** (nr. rendor **6**. në Tabelë) i plotësojnë më së miri kushtet e parapara, pasi posedojnë specializim në fushën e Hematologjisë, e cila është fusha konkrete për të cilën është shpallur angazhimi. Prandaj këta dy kandidatë **PROPOZOHEN** që të emërohen bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime në Lëndën Mjekësi Interne – Hematologji, për vitin akademik 2026/2027.

Kandidati Hajdin Çitaku ( nr.rendor 1. Në Tabelë), ka specializim të përafërt (Mjekësi Interne – Kardiologji), ndërsa kandidatja Ermira Bajrami ( nr.rendor 4. Në Tabelë) është në vitin e tretë të specializimit të përafërt (Mjekësi Interne), por që të dy bien ndesh me Nenin 7, pika 3.4 të Rregullores nr. 2/254, dt. 17/7/24, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP, dhe rrjedhimisht NUK PROPOZOHEN si bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime në Lëndën Mjekësi Interne – Hematologji.

Kandidati Erblin Beqiraj (nr.rendor 5. Në Tabelë) është specialist i Kardiokirurgjisë, që bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17/7/24, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP, prandaj NUK PROPOZOHET si bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në Lëndën Mjekësi Interne – Hematologji.



Scanned with CamScanner

Kandidatja Liridona Gashi (nr.rendor 2. Në Tabelë) nuk është specialiste as specializante, që bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17/7/24, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP, prandaj NUK PROPOZOHET për bashkëpunëtore të jashtme për ushtrime në Lëndën Mjekësi Interne – Hematologji.

Kandidatja Vlora Bujupaj (nr.rendor 7. Në Tabelë ) nuk e ka diplomën e Studimeve Themelore të Mjekësisë së Përgjithshme, që bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17/7/24, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP prandaj NUK PROPOZOHET, as nuk mund të merret parasysh në këtë Konkurs.

Pra, pas shqyrtimit të dokumentacionit të të gjithë kandidatëve, Komisioni ka konstatuar se vetëm dy kandidatët e propozuar kanë specializim në fushën e Hematologjisë, e cila është fusha konkrete për të cilën është shpallur angazhimi dhe nuk bien ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP.



Scanned with CamScanner